

VENDIM

Nr. 359, datë 29.5.2019

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 669, DATË 7.8.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR PËRCAKTIMIN, KRIJIMIN DHE REALIZIMIN E KORNIZËS REFERUESE SHQIPTARE (KRGJSH), SI METADATË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1 e 4, të nenit 13, të ligjit nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 669, datë 7.8.2013, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:
“2. Ngarkohet Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor për zbatimin e këtij vendimi.”.
2. Në tekstin e rregullave, bashkëlidhur vendimit, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:
 - a) Pika 9, e nenit 2, ndryshohet, si më poshtë vijon:
“9. Rrjeti shtetëror i pozicionimit global” është rrjeti që mundëson pozicionimin, bazuar në sistemet GNSS.”.
 - b) Pika 1, e nenit 3, ndryshohet, si më poshtë vijon:
“1. Sistemi referues gjeodezik që do të përdoret në Republikën e Shqipërisë do të quhet Korniza Referuese Gjeodezike Shqiptare ose shkurt KRGJSH.”.
 - c) Shkronja “a”, e pikës 1, të nenit 5, ndryshohet, si më poshtë vijon:
“a) rrjetin shtetëror të pozicionimit global;”.
 - ç) Shkronja “e”, e pikës 1, të nenit 6, ndryshohet, si më poshtë vijon:
“e) sistemin shtetëror për ndarjen dhe emërtesën e fletëve të hartave (nomenklatura), që përcaktohet me vendim të ASIG-ut.”.
 - d) Në nenin 8 termi “GPS” zëvendësohet me fjalët “i pozicionimit global”.
 - dh) Pas nenit 8/1 shtohet neni 8/1/a, me këtë përmbajtje:

“Neni 8/1/a

Stacionet e rrjetit aktiv të pozicionimit global ALBPOS, që posedohen nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, kalojnë në administrim të ASIG-ut dhe integrohen në rrjetin aktiv të stacioneve CORS.”.

- e) Neni 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 9

Radha e kryerjes së punimeve dhe përgatitja e instruksioneve me kërkesat teknike për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrjeteve të parashikuara në nenin 5, përcaktohen dhe miratohen nga ASIG-u.”.

- ë) Shtesa II shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe